



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e76-të, të mbajtur më 25.10.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-3434/1 datë 01.10.2020, NDËRPRITET
KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Lënda me numër 12-3434 të vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-3434/1të datës 20.07.2020 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Akuzat e bëra në denoncim kanë të bëjnë me dyshimet për punësim të paligjshëm të personit zyrtarë në // (në tekstin e mëtejshëm: ///) ///, i cili u punësua në // pa përfunduar një arsim të mesëm 4-vjeçar dhe ndërkohë, personi u emërua komandant i // pa pasur të përfunduar fakultet. Personi në kohën e paraqitjes së kërkesës ishte student i ///. Në të njëjtën kohë, sipas pretendimeve në denoncim, në /// janë punësuar tre persona në mënyrë të kundërligjshme, pa qenë të regjistruar në marrëdhënie të rregullt pune, siç kërkohet me ligjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe disa nga të punësuarit në /// janë siguruar në mënyrë të paligjshme për të punuar me kohë të pjesshme 4 (katër) orë në ditë. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit është dorëzuar fotokopje e diplomës për dhënien e provimit përfundimtar për arsimin e mesëm profesional të personit zyrtarë të patheksuar në denoncim, si dhe fotokopje e certifikatës së tij për arsimin e specializuar.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente për rastin konkret nga Inspektorati Shtetëror i Punës i RMV-së dhe nga Inspektorati Administrativ Shtetëror i RMV-së. Nga njoftimet e tyre rezultoi se personi zyrtarë i theksuar në denoncim nuk ishte i punësuar në detyrën e komandantit të ///, por në detyrën e komandantit të një departamenti në ///, për të cilin, sipas aktit të sistemimit, për vendin e punës kërkohet të ketë përfunduar arsimin e lartë ose të mesëm. Ky kusht është përmbushur nga personi zyrtar i theksuar në denoncim që nga momenti i punësimit të tij në ///. Përveç kësaj, në

lidhje me pretendimet për punë të paligjshme të personave zyrtarë, d.m.th. për punën me kohë të pjesshme, Inspektorati Shtetëror i Punës i RMV-së dhe Inspektorati Administrativ Shtetëror i RMV-së deklaruan se nuk gjetën asnjë provë që tregonte një veprim të tillë të palejueshëm nga udhëheqësia///. Prej aty, KSHPK-ja i vlerësoi pretendimet në denoncim si të pabazuara në tërësinë e tyre.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Arkivi i KSHPK -së

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: S. P. D.

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetare,
Biljana Ivanovska

